



#EENCanHelp

NetLife  
NEWS FOR NETWORK PARTNERS  
EEN Albania

## INFO DAY PËR BIZNESET NË QARKUN GJIROKASTËR

Stafi AIDA-s dhe EEN -Albania, në kuadër të informimit të bizneseve vendase u ndal në qytetin e Gjirokastrës për të mbajtur një takim informues me bizneset e këtij qarku.

Pergjatë takimit, përfaqësuesit nga bizneset pjesëmarrëse ngriten çështje dhe problematika konkrete të hasura në punën e tyre të përditshme veçanërisht në sektorin e artizanatit dhe turizmit. Bizneset kërkuan trajnime, mundësi inovative për promovimin e bizneseve të tyre, asistencë nga AIDA për aplikimin e fondeve, rritjen e kapaciteteve për shitjet online etj. U diskutua mbi promovimin e produkteve **“Made in Albania”**, gjithashtu për zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja në mbështetje të biznesit shqiptar.


Pjesëmarrësve ju prezantua Rrjeti Europian i Ndërmarrjeve (EEN Albania) dhe shërbimet që rrjeti ofron për NVM-të shqiptare me synim rritjen e aftësisë konkurruese dhe inovative të tyre në tregun Europian e më gjerë.



## 2. Takim me Agjencinë Prishtina Rea

Stafi i EEN - Albania dhe AIDA-s priti në takim Prishtina REA, një agjenci kosovare e angazhuar në zhvillimin ekonomik, sektorin privat, rininë e punësimit, bashkëpunimet ndërkombëtare dhe njëkohësisht pjesë e programit COSME EEN-Kosova. Gjatë takimit u diskutua mbi ecurinë e programit në Shqipëri dhe e praktikave implementuese, rrjetëzimin dhe shkëmbimin eksperiencës mes SME-ve, si edhe mundësitë për partneritete e bashkëpunime ndërkombëtare. Gjatë takimit u bë një prezantim mbi Rrjetin European të Ndërmarrjeve, me shërbimet që ai ofron për mbështetjen dhe rritjen e biznesit, si dhe programit COSME, si një mjet i rëndësishëm financiar dhe teknik për të mundësuar zgjerimin e tregut të biznesit drejt tregut unik European, drejt përqasjes në inovacion, teknologji të reja dhe kërkim zhvillimin.

Ky takim do të jetë një mundësi e mirë për fillimin e një bashkëpunimi mbi mundësitë konkrete lidhur me identifikimin e pikave të përbashkëta në kuadër të misioneve të ngjashme të institucioneve dhe roleve përkatëse në Rrjetin European të Ndërmarrjeve.



## RRJETI EUROPIAN I NDËRMARRJEVE (EEN-Albania)

### Çfarë është Rrjeti European i Ndërmarrjeve?


- ❖ Rrjeti më i madh në botë për nxitjen e konkurrueshmërisë dhe sipërmarrjen.
- ❖ Nxit rritjen e bizneseve dhe punës duke ofruar shërbime për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme NVM/ SME si dhe burime për biznese të tjera, universitete dhe qendra kërkimore.
- ❖ Ofron shërbime mbështetëse për të ndihmuar NVM-të të bëjnë biznes në Tregun Unik BE, si dhe të përmirësojnë konkurrencën e NVM-ve Europiane.

### Si funksionon Rrjeti?

- ❖ Për t'u bërë pjesë e Rrjetit duhet të krijoni profilin e biznesit tuaj në databazën e Rrjetit.
- ❖ Profili krijohet nga biznesi në bashkëpunim me ekspertët e Konsorciumit Shqiptar.
- ❖ Profili vendoset në Rrjet nga ekspertët e Konsorciumit Shqiptar në bashkëpunim me ekspertët e BE.
- ❖ Ky shërbim nuk ka asnjë kosto për biznesin.

Enterprise Europe Network (EEN-Albania) në përshtatje me situatën e krijuar nga COVID-19, ju rikujton se ne vazhdojmë të jemi në dispozicion me shërbimet tona.

## SHESHO KURBËN! RESPEKTO MASAT PARANDALUESE



### Rjeti European i Ndërmarrjeve

Rrjeti më i madh në botë për mbështetjen e NVM-ve me fokus ndërkombëtarizimin

## EENCanHelp

**Vizitoni:**

**[www.een.al](http://www.een.al)**

**[een.ec.europa.eu](http://een.ec.europa.eu)**

